



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, në pajtim me autorizimet e dhëna në dhëna me nenin 10.3 të Ligjit nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, nenin 37.2 (pika c), të Ligjit Nr.03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 5, 6, 7 të Udhëzimit Administrativ për Zëvendësimin e Anëtarit të Kuvendit Komunal, Nr.01/2017, si dhe Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese, KI45/2020 dhe KI46/20, në mbledhjen e rregullt të mbajtur më datë 20.04.2023, merr këtë:

V E N D I M

- I. **Znj.Florida Bajraktari**, emërohet anëtare e Kuvendit Komunal në Rahovec, nga subjekti politik “Partia Demokratike e Kosovës”, duke e zëvendësuar anëtarin e Kuvendit Komunal znj.Ellma Hamza.
- II. Obligohet Sekretariati i KQZ-së, që ky vendim t’i komunikohet znj.Florida Bajraktari dhe të ndërmerren veprimet procedurale për zbatim.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka shqyrtuar shkresat e lëndës të dorëzuara në KQZ më datën 12.04.2023, Nr.09-1-408-2023, për zëvendësimin e anëtares të Kuvendit Komunal znj. Ellma Hamza, për arsye të punësimit në arsim.

Pas shqyrtimit të kërkesës dhe shkresave të bashkangjitura, është verifikuar dhe konstatuar se, kandidatja në listën e rirënditur është znj.Florida Bajraktari.

Kandidatja e radhës ka dhënë deklaratën e pranimin të mandatit, nga i njëjti subjekt politik, i gjinisë së njëjtë, me numër më të madh të votave, duke mos tejkaluar kuotën prej 30 % , të kufirit minimal të përfaqësimit gjinor të gjinisë pakicë, sipas rezultateve të certifikuar të zgjedhjeve lokale të vitit 2021.

Andaj, pas plotësimit të të gjitha kushteve ligjore, KQZ vendosi si në pikën I të këtij vendimi.

Prishtinë, 20.04.2023

Kryesues
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

Kreshnik Radoniqi





Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, në pajtim me autorizimet e dhëna në dhëna me nenin 77.4 të Ligjit Nr.03/L-073, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në mbledhjen e rregullt të mbajtur më datë 20.04.2023, merr këtë:

V E N D I M

Për Miratimin e Plotësim/Ndryshimeve të Përbërjes së KVV-ve për Komunitetet Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë e Veriut

- I. Miratohet plotësim/ndryshimi i përbërjes së KVV-ve, për komunitetet Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë e Veriut, për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar të Komuniteteve: Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok, si dhe zgjedhjet e parakohshme për kuvendet e komuniteteve: Zveçan dhe Leposaviq, që do të mbahen më 23 prill 2023.
- II. Tabela me plotësim/ndryshime, si në pikën I është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
- III. Obligohet Sekretariati i KQZ-së, për zbatimin e këtij vendimi.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 20.04.2023

Kryesues
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

Kreshnik Radoniqi





Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, në pajtim me autorizimet e dhëna në dhëna me nenin 64.2 të Ligjit Nr.03/L-073, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, si dhe bazuar në vendimin e Presidentes të Republikës së Kosovës të datës 10.12.2022, Nr.09/1637/2022, për shtyrjen dhe caktimin e datës së re të zgjedhjeve të jashtëzakonshme për Kryetar të Komunave: Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok, si dhe zgjedhjeve të parakohshme për kuvendet e komunave: Zveçan dhe Leposaviq, në mbledhjen e rregullt të mbajtur më datë 20.04.2023, merr këtë:

V E N D I M

Për Miratimin e Planit Operacional të Veprimit për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunave: Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok, si dhe Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendet e Komunave: Zveçan dhe Leposaviq

- I. Miratohet Plani Operacional i Veprimit, për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar të Komunave: Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok, si dhe zgjedhjet e parakohshme për kuvendet e komunave: Zveçan dhe Leposaviq, që do të mbahën më 23 prill 2023.
- II. Plani, si në pikën I është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
- III. Obligohet Sekretariati i KQZ-së, për zbatimin e këtij vendimi.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 20.04.2023

Kryesues
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve


Kreshnik Radoniqi





Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, në pajtim me autorizimet e dhëna në dhëna me nenin 64.2 të Ligjit Nr.03/L-073, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, si dhe bazuar në vendimin e Presidentes të Republikës së Kosovës të datës 10.12.2022, Nr.09/1637/2022, për shtyrjen dhe caktimin e datës së re të zgjedhjeve te jashtëzakonshme për Kryetar të Komunave: Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok, si dhe zgjedhjeve të parakohshme për kuvendet e komunave: Zveçan dhe Leposaviq, në mbledhjen e rregullt të mbajtur më datë 20.04.2023, merr këtë:

V E N D I M

Për Miratimin e Dizajnit të Vulës së Fletëvotimit për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunave: Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok, si dhe Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendet e Komunave: Zveçan dhe Leposaviq

- I. Miratohet dizajni i vulës së fletëvotimit, për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar të Komunave: Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok, si dhe zgjedhjet e parakohshme për kuvendet e komunave: Zveçan dhe Leposaviq, që do të mbahën më 23 prill 2023.
- II. Dizajni i vulës, si në pikën I është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
- III. Obligohet Sekretariati i KQZ-së, për zbatimin e këtij vendimi.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 20.04.2023

Kryesues
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve


Kreshnik Radoiqi